

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "KAP" është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 10/09/1993 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, me NIPT: J62903833Q

Selia e shoqërisë është: Lagjia 3, Kavajë

Kapitali themeltar: 3,777,511.50 lekë

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 kuotë dhe zotërohen nga ortaku:

- Shoqëria "BA Investment" zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 3,116,446.99 lekë ose 82,50 % të kapitalit
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikë zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 661,064,51 lekë ose 17,50 % të kapitalit

Administratorët e shoqërisë janë Z. Apostol Goci.

Aktiviteti i shoqërisë është: Rritjen e peshkut dhe të konservimit të tij

Gjatë vitit 2021 shoqëria kishte mesatarisht 4 punonjës.

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1 – Deklarata e Pajtuëshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### 2.2 – Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në kostot historike.

### 2.3 – Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë të shprehura në LEKË, e cila është monedha funksionale e Shqipërisë.

### 2.4 – Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të vijojë për të paktën 12 muaj të ardhshëm nga data e pasqyrave financiare.

### 2.5 – Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë vlerësimë dhe supozime që ndikojnë në shumat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultati mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht duke u bazuar në faktorë që rrisin pritshmëri në të ardhmen të cilat besohen të jenë të arsyeshme dhe të besueshme. Vlerësimet dhe gjykimet që kanë risk më të lartë për të shkaktuar korigjime të pasqyrave financiare janë:

#### 2.5.1 – Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuarat të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet. Këto vlerësime bazohen moshën e llogarive të arkëtueshme, nga mundësia që klienti të falimentojë apo të bëjë një riorganizim financiar, dhe nga aftësia paguese e klientit. Drejtimi vlerëson nëse në fund të vitit është e nevojshme zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2 – Provizionet

Provizionet kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, sidomos në rastet e padive gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të ndonjë detyrimi aktual i cili vjen nga ngjarje të shkuar, mundësia e ndodhjes është 50% dhe shuma e



detyrimet mund të matet me besueshmëri. Drejtimi vlerëson nëse në fund të vitit është e nevojshme krijimi i provizioneve.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistentë në të gjitha periudhate paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 – Aktivet Afatgjata Materiale

##### I. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimet dhe amortizimet e akumuluar. Kosto përfshin të gjitha blerjet që janë të lidhura drejtëpërdrejtë me aktivin. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe të punës së kryer, çdo kosto tjetër të lidhur drejtëpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen si “ndërtim në proces” dhe pasi përfundon ndërtimi transferohet në llogarinë përkatëse të aktivit, nga ku më pas fillon amortizimi i aktivit sipas normave të amortizimit.

Në rastet kur një pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zë të ndryshme të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjen nga shitjet e aktiveve apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, duke e përfshirë këtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### II. Kostot mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të aktivit afatgjatë material njihen më vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria të realizojë përfitime të ardhshme ekonomik nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

##### III. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale përdoret metoda lineare.

Amortizimi vjetor i aktiveve afatgjatë material është si më poshtë:

<u>Zërat e aktiveve</u>	<u>Norma e amortizimit</u>
1. Ndërtesa	5%
2. Makineri dhe pajisje	20%
3. Mjete transporti	20%
4. Pajisje zyre	25%
5. Aktivet Afatgjata Jomateriale	15%

##### IV. Çregjistrimi

Një zë i aktivit afatgjatë material çregjistrohet kur ai del jashtë përdorimit ose kur nga ai aktiv shoqëria nuk pret prej tij më përfitime ekonomike nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet, kur aktivi nxirret jashtë përdorimit, përcaktohen sipas vlerës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.2 – Inventarët

##### I. Njohja dhe matja



Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtëpërdrejtë me prodhimin si dhe kostot e shëndrrimit të këtyrë materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtëpërdrejta përfshijnë çmimin e blerjes dhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Kostot e lëndëve të para, materialeve të konsumit përbëhet nga çmimi i blerjeve, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shpenzime të tjera të ngjashme.

#### II. Vlerësimi i mëpasshëm

Pas njohjes, shoqëria e mat inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu shitur.

#### III. Zhvlerësimi i inventarit

Inventarët i nënshtrohen testit për zhvlerësim në datën e raportimit. Diferenca ndërmjet vlerësimit të inventarit me kosto dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me me kostot e shitjes, regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si humbje nga zhvlerësimi i inventarëve.

#### IV. Çregjistrimi

Inventari çregjistrohet kur shitet. Njësia ekonomike duhet ta çregjistrojë inventarin edhe në ato raste kur ai nuk ka më vlerë ekonomike në të ardhmen, si psh inventari i vjetëruar.

### 3.3 – Llogari dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogariten kur ka të dhëna se shoqëria nuk është në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet e saj. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë apo riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme do të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

### 3.4 – Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse, dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to maten/mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

### 3.5 – Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen me vlerën e tregut pa përfshirë kostot e transaksioneve. Pas njohje fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin e efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.


### 3.6 – Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke përdorur normën e interesit efektiv.

### 3.7 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

### 3.8 – Transaksionet në monedhë të huaj





(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme në datën e raportimit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit për Euro dhe Dollarë më 31 dhjetor 2021 sipas Bankës së Shqipërisë paraqitet si më poshtë:

<u>Monedha</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
1 EUR	120.76	123.70
1 USD	106.54	100.84

### 3.9 – Të ardhurat dhe të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime në të ardhmen dhe këto të ardhura do të maten me besueshmëri. Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të arkëtuar apo të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e çfarëdolloj zbritjeje tregtare, zbritje për arkëtim të menjëhershme apo për sasitë e blera. Të ardhurat regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit janë të ardhurat që vijnë jo në rrjedhën normale të aktivitetit ekonomik të shoqërisë duke përfshirë fitim/humbjen nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjen nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të kursit që lidhen nga aktivitete financiare dhe investuese.

### 3.10 – Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzime financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kostot e huamarrjes njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.11 – Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si qira operative dhe qira financiare. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiar në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë gjithë periudhës së qirasë.

### 3.12 – Pagat dhe sigurimet

Shoqëria paguan kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme sipas legjilacionit në fuqi. Pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan shoqëria në emrin e saj njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.13 – Tatim mbi fitimin

Tatim mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat" (i ndryshuar). Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshëm. Norma e tatimit mbi fitimin me datë 31 dhjetor 2021 është 15% (më 31 dhjetor 2020: 15%).



(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë me datë 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Arka	1,948	1,948
Lekë	1,948	1,948
Euro	-	-
<b>Banka</b>	<b>376</b>	<b>376</b>
Lekë	376	376
Euro	-	-
<b>Totali</b>	<b>2,324</b>	<b>2,324</b>

**5. Llogari të arkëtueshme dhe kërkesa të tjera të kërkueshme**

Llogaritë e arkëtueshme me datë 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Kërkesa të arkëtueshme	9,009,600	9,009,600
Instrumenta të tjera borxhi	-	-
Aktive tatimore të Shtyra (Tatim mbi fitimin)	-	-
TVSH për tu rimbursuar	-	-
Tatim Fitimi i mbi paguar	-	2,426,456
TVSH e zbritshme	-	-
<b>Totali</b>	<b>9,009,600</b>	<b>11,436,056</b>

**6. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra me datë 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**7. Inventarët**

Inventarët me datë 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Lëndë e parë	20,280	20,280
Prodhim në proces	-	-
Produkt i gatshëm	-	-
Mallra për shitje	-	-
Invenatr i imët	60,800	60,800
<b>Totali</b>	<b>81,080</b>	<b>81,080</b>

**8. Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale**

Shtesat dhe pakësimet e aktiveve afatgjatë materiale dhe jomateriale gjatë vitit 2021 dhe amortizimi paraqiten si më poshtë:

	<b>Ndërtesa</b>	<b>Ndërtime themelore impjanti</b>	<b>Mjete transporti</b>	<b>Makineri dhe pajisje</b>	<b>Orendi dhe pajisje</b>	<b>TOTALI</b>
Gjendja fillestare (01.01.2021)	22,439,278	61,067,875	3,936,930	26,338,022	658,060	114,440,165
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje në fund (31.12.2021)</b>	<b>22,439,278</b>	<b>61,067,875</b>	<b>3,936,930</b>	<b>26,338,022</b>	<b>658,060</b>	<b>114,440,165</b>
Amortizimi i Akumuluar (01.01.2021)	3,213,320	13,232,778	2,108,931	8,618,900	615,085	27,789,015



KAP shpk

Shënimet Shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura me datë 31 dhjetor 2021

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

Shtesa	-	-	-	-	-	-
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendje në fund (31.12.2021)	<u>3,213,320</u>	<u>13,232,778</u>	<u>2,108,931</u>	<u>8,618,900</u>	<u>615,085</u>	<u>27,789,015</u>
Vlera neto kontabël 31.12.2021	<u>19,225,958</u>	<u>47,835,097</u>	<u>1,827,999</u>	<u>17,719,122</u>	<u>42,975</u>	<u>86,651,150</u>

#### 9. Overdraft dhe Qiratë Financiare (Leasing)

Overdrafti dhe qiratë financiare me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Qira financiare (Leasing)	-	-
Overdraft	-	-
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>-</u>

#### 10. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme gjatë vitit 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të pagueshme ndaj furnitorëve AQT	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorit	840,000	-
<b>Totali</b>	<u>840,000</u>	<u>-</u>

#### 11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore me datë 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime Tatimore TVSH për t'u paguar	-	706,657
Gjoha dhe interesa	2,048,157	-
Detyrime Tatimore Tatim mbi Fitimin për t'u paguar	-	-
Detyrime Tatimore Tatim mbi të Ardhurat	-	435,521
<b>Totali</b>	<u>2,048,157</u>	<u>1,142,178</u>

#### 12. Detyrime për paga dhe sigurime

Detyrimet për paga dhe sigurime 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të pagueshme ndaj personelit	15,529,336	13,823,104
Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore	4,470,393	3,797,884
<b>Totali</b>	<u>19,999,729</u>	<u>17,620,988</u>

#### 13. Parapagime të arkëtuara dhe të ardhura të shtyra

Parapagimet e arkëtuara dhe të ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagimet e arkëtuara	-	-
Grandet dhe Të Ardhurat e Shtyra	-	-
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>-</u>

#### 14. Hua të tjera afatshkurta

Huatë e tjera afatshkurtra me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huatë të tjera	-	-
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>-</u>

#### 15. Huatë afatgjata



**KAP shpk****Shënimet Shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura me datë 31 dhjetor 2021**

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

Huatë afatgjata me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huara të tjera	165,593,295	168,701,407
<b>Totali</b>	<b>165,593,295</b>	<b>168,701,407</b>

**16. Kapitallet e veta**

Kapitali themeltar dhe rezervat me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Kapitali i shoqërisë	3,777,511	3,777,511
Rezervat Statutore	-	-
Rezervat Ligjore	-	-
Rezervat të tjera	(93,071,474)	(78,095,443)
Fitimi i pashpërndarë	-	-
Fitimi humbje e vitit financiarë	(3,443,064)	(14,976,031)
<b>Totali</b>	<b>-92,737,027</b>	<b>- 89,293,963</b>

**17. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shitje të prodhimit të vetë	-	-
Shitja e shërbimeve	-	-
Shitje mallra	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**18. Të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shitje nga AAM	-	-
Prodhimi i AAM	-	-
Qira	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**19. Ndryshimi i produktit të gatshëm**


Ndryshimi i produktit të gatshëm për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Produkti i gatshëm	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**20. Kosto mallrave dhe materiale të konsumuara**

Në këtë zë përfshihen kosto e mallrave, materialeve dhe shërbimeve të konsumuara gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit. Kosto e mallrave dhe materialeve të konsumuara gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Materiale	(264,396)	(1,070,489)
Mallra	-	-
<b>Totali</b>	<b>(264,396)</b>	<b>(1,070,489)</b>

**21. Shpenzime për personelin**




**KAP shpk****Shënimet Shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura me datë 31 dhjetor 2021**

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

Shpenzimet për personelin përfshijnë shpenzimet për pagat dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që shoqëria paguan në emër të saj. Shpenzimet për personelin gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Pagat	(2,004,000)	(1,872,000)
Sigurime shoqërore	(334,668)	(385,944)
<b>Totali</b>	<b><u>(2,338,668)</u></b>	<b><u>(2,257,944)</u></b>

**22. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>
Auditime PF	840,000
<b>Totali</b>	<b><u>840,000</u></b>

**23. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat që vijnë nga interesa të fituara dhe diferenca kursi positive dhe shpenzimet e interesave të paguara dhe diferenca kursi negative.

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare të tjera	-	-
Interesa të paguara dhe diferenca kursi negative	-	-
Interesa të fituara dhe diferenca kursi pozitive	-	-
Të ardh/shpenz nga shitja e AAM-vlera/kontabël	-	(11,647,598)
<b>Totali</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>(11,647,598)</u></b>

**24. Llogaritja e fitim/humbjes së vitit ushtrimor**

Llogaritja e rezultatit të vitit ushtrimor për 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Fitim/Humbja para tatimit	(3,443,064)	(14,976,031)
Tatim mbi fitimin	-	-
Fitim/Humbja kontabël neto	(3,443,064)	(14,976,031)
Shpenzime të panjohura	-	-
Mbartja e humbjes	-	-
Fitim/Humbja para tatimit	(3,443,064)	(14,976,031)
Tatim mbi fitimin	-	-
<b>Fitim/humbja e viti ushtrimor</b>	<b><u>(3,443,064)</u></b>	<b><u>(14,976,031)</u></b>

**25. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra prej tyre mund të kontrollojë ose të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm në marrjen e vendimeve operative dhe financiare të palës tjetër. Gjatë marrjes në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme midis palëve, vëmendje i kushtohet përmabajtjes së marrëdhënieve dhe jo thjeshtë formës ligjore. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohet si palë e lidhur.

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Hua nga ortakët	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>-</u></b>



KAP shpk

Shënimet Shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura me datë 31 dhjetor 2021

---

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në lekë)

**26. Ngjarje pas datës së raportimit**

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare.

*Arbën Gashi*

*[Signature]*

Kavaja Aquaculture Production  
K. A. P. sh.p.k.  
6987 GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
KAVAJE - ALBANIA